




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

SHKOLLA PROFESIONALE "BEQIR ÇELA" DURRËS



Nr. 250 prot.

Data: 25/06/2024

Lënda : Njoftim për vënd të lire pune

Drejtuar: DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMËVE NJERËZORE

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucionëve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimëve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit",

Ofruesi publik I AFP-së Shkolla profesionale "Beqir Çela", ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

1. Sekretare 1(një)vend vakant .

A - Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

1. Kriteret e përgjithshme:

Aplikanti duhet të përmbushë këto kritere:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;

- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

2. Kriteria të posaçme :

- a) të ketë nivelin arsimor të mesëm ose shkollë të mesme profesionale, në fushën në shpalljen për pozicionin përkatës;
- b) të ketë përvojë në punë të paktën një vit sipas përcaktimëve në shpalljen për pozicionin përkatës;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

B - Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi;
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën/dëftesën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) çertifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- i) vërtetim banimi

✓ Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

✓ Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda

dates 18.07.2024

Drejtor

Fatmir Merkuri

